



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2018:034522
Datë: 16.04.2024
Numri i dokumentit: 05577108

PAKR.nr.230/2024

GJYKATA E APELIT TË KOSOVËS- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtai, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Xhevdet Abazi, anëtar me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.L., nga fshati, Komuna e Deçanit, për shkak të dy veprave penale të grabitjes nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit E.L., të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.543/2023, të dt.14.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e të akuzuarit E.L., e ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.543/2023, të dt.14.02.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, PAKR.543/2023, të dt.14.02.2024, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.315/2015, i dt.06.01.2023.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.315/2015, i dt.06.01.2023, është shpallur fajtor i akuzuari E.L., për shkak të dy veprave penale të grabitjes nga neni 255 par.3 lidhur me par.1 dhe lidhur me nenin 23 të KPK, ashtu që për secilën vepër penale i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nga 1(një)viti, dhe në kuptim të dispozitës ligjore nga neni 76 par.1 lidhur me par.2 pika 2.2 të KPK, i është

shqiptuar dënimi me burgim unik, në kohëzgjatje prej 1(një)viti e 6 (gjashtë) muaj, në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga dt.14.12.2010, gjerë me dt.12.04.2011, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, shumën prej 50 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Po ashtu është obliguar i akuzuari që barnatores “Meha Farm”, e cila gjendet në Pejë, në rrugën “Nëna Terezë”, me pronare E.M., ti paguajë dobinë pasurore në shumën prej 250 (dyqindpesëdhjetë) Euro, në mënyrë solidare me të gjykuarin L.B., i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, nën shenjën P.nr.67/2012, të dt.11.01.2016, si dhe barnatores “Valerina”, që gjendet në Deçan, në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, me pronar S.B., ti paguajë shumën prej 550 (pesëqindpesëdhjetë) Euro, në mënyrë solidare me të gjykuarin A.D., i dënuar me aktgjykim të formës së prerë nën shenjën P.nr.67/2012, të dt.11.01.2016.

Të dëmtuarat M.Sh. dhe H.A., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar ankesën e ushtruar nga ana e të akuzuarit dhe në kuptim të nenit 408 par.1 lidhur me nenin 411 par.2 të KPPK, përkitazi me procedurat për paraqitjen e ankesës kundër aktvendimit ose urdhrorit ka ardhur në përfundim se: “ankesa e cila nuk paraqitet në pajtim me këtë kapitull, mund të hedhet menjëherë nga Gjykata e Apelit, pasi të jetë siguruar se në ankesë nuk ngritet ndonjë çështje e rëndësishme lidhur me të drejtat e Kushtetutës së garantuar”. Nga kjo rezulton se kjo çështje penale është e gjykuar dhe e vendosur nga ana e Gjykatës së Apelit, ashtu që nuk mund të ketë gjykim të përsëritur, sepse shkeljet parimi “ne bis in idem”, nga neni 4 i KPPK, ngase njëherë është zhvilluar procedurë.

Duke vlerësuar shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar si dhe ankesën e ushtruar nga ana e të akuzuarit E.L., kolegji i kësaj gjykate në kuptim të nenit 408 lidhur me nenin 411 par.2 të KPPK, ankesën e ka hedhur poshtë si të pa lejueshme.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.230/2024, të dt.16.04.2024

Sekretare juridike,
Fitnete Hoti

Kryetare e Kolegjit
Kadrije Goga Lubishtani